



QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMIN  
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

## **LËNDA: FTESË PËR OFERTË PËR BLERJE PRODUKTESH DHE SHËRBIMESH**

Të nderuar,

Nëpërmjet kësaj letre, ju ftojme të paraqesni ofertën tuaj lidhur me blerjen e produkteve dhe shërbimeve për kryerjen e printimeve të materialeve informuese që do të zhvillohet nga organizata Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QShPZh).

### **Informacion i përgjithshëm rreth QShPZh**

QShPZh-ja është një organizatë jo fitimprurëse, e themeluar në Janar të vitit 1993, e cila punon për përmirësimin e politikave, legjislacionit, të drejtën për informacion dhe shërbime për çështje që shqetësojnë popullatën dhe zhvillimin e saj, përfshirë shëndetin riprodhues.

*Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QShPZh), në kuadër të përmbushjes së qëllimeve të punës së saj do të prodhojë materiale informuese.*

## **TERMA REFERENCE**

### **1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT**

Synimi i përgjithshëm është blerja e produkteve dhe shërbimeve për printimin e materialeve informuese. Respektivisht: printimeve të fletpalosjeve, posterave dhe procedurave.

### **1. Data dhe vendi**

Me kërkesë të organizatës, ofertat e produkteve dhe shërbimeve do të dorëzohen në Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin adresa: Bulevardi “Gjegj Fishta”, Nd.26, H.6, Ap.5, 1001, Tiranë. Tel: +042251475



QENDRA SHQIPTARE PER POPULLSINE DHE ZHVILLIMIN  
ALBANIAN CENTER FOR POPULATION AND DEVELOPMENT

## 2. Profili i kërkuar i aplikantit

1. Subjekt tregtari i regjistruar konform legjislacionit shqiptar në fuqi.

## 3. Përzgjedhja dhe Tarifat

Operatori ekonomik i cili do të përzgjidhet për ofrimin e shërbimit të lartë përmendur, do ti kryhet pagesa pas dorëzimit të produkteve dhe shërbimeve dhe faturës përkatëse në llogarinë bankare të subjektit.

### **Aplikimi**

Ju ftojmë të shprehni interesin tuaj duke dërguar aplikimet tuaja me postë ose dorazi në adresën (adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd.26, H.6, Ap.5, 1001, Tiranë).

Dokumentat e aplikantit si më poshtë:

- Oferta Financiare përfshirë TVSH për shërbimin që kërkohet.

### **Vlerësimi i ofertave:**

Të gjithë ofruesit do të vlerësohen për ofertën më të ulët financiare.

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (QShPZh), inkurajon çdo ofrues shërbimi të mundshëm të shmangë dhe të parandalojë konfliktet e interesit.

*Për çdo pyetje, ju lutem mos ngurroni ti adresoni në adresën e email: [info@acpd.org.al](mailto:info@acpd.org.al)*